1.2. Artikuj me tekst të plotë (punime origjinale empirike, rishikim literature, prezantime të projekteve hulumtuese, letra për editorin, etj.) që bartin adresën e Universitetit të Prishtinës (affiliations), të botuara në revista shkencore që nuk mbulohen nga Clarivate Analytics – Web of Science, të indeksuara në SCOPUS (*Grupi 2: Q1; Q2; Q3 dhe Q4*).

1.3. Libra të shkruar dhe monografi, si produkt i kërkimit original ose kapituj në një libër të tillë me adresë të Universitetit të Prishtinës dhe të botuar nga shtëpi botuese të njohura në vendet e përparuara shkencërisht (*Grupi 3: shtëpitë më të mëdha botuese: Cambridge University Press; Oxford University Press; Thomson Reuters; Springer Nature; Routledge; Elsevier; Wiley; Peter Lang; Blackwell; De Gruyter; RELX Group; Bertelsmann; SAGE; Pearson; Wolters Kluwer; Hachette Livre; Grupo Planeta; Schoastic; McGraw Hill*).

2. Veprimtaria hulumtuese/shkencore që është botuar apo botohet në revista dhe shtëpi botuese të dyshimta nuk mund të financohet nga programi PNPSH.

Neni 6

Aktivitetet shkencore të pranueshme dhe llojet e pjesëmarrjes për PNPSH

1. Aktivitetet shkencore të pranueshme për PNPSH janë kryesisht kongrese ndërkombëtare, konferenca, simpoziume, ngjarje artistike dhe sportive të organizuara jashtë vendit. Gjithashtu edhe ngjarjet ndërkombëtare të mbajtura në Kosovë dhe rajon, me borde editoriale ndërkombëtare shkencore, organizuese dhe ekzekutive, janë të pranueshme për PNPSH.

2. Aktivitetet shkencore, artistike e sportive, në të cilat do të marrë pjesë personeli akademik që aplikon për PNPSH, duhet të korrespondojnë me fushën përkatëse të personelit. Mbështetja nuk do të aprovohet, nëse kandidati që i ndjek aktivitetet shkencore apo ngjarjet artistike e sportive nuk korrespondon me fushën e tij të specializimit.

3. Ata që kanë punime, të cilat janë pranuar për prezantim në kongrese ndërkombëtare, konferenca, simpoziume ose në disa fusha të shkencës, përfshirë pjesëmarrjen me postera ekuivalentë me kumtesa, ose ata që marrin pjesë në bordet shkencore, organizative, ekzekutive të ngjarjeve të tilla ose paraqiten si folës, panelistë, kryetarë të takimit/sesionit ose në pozicione të ngjashme (grupi A) kanë të drejtë për mbështetje të plotë financiare, sipas kuotës së përcaktuar me këtë rregullore.

4. Personeli akademik, i cili merr pjesë në ngjarje të tilla vetëm si bashkëpjesëmarrës (bashkautor) në konferencë (grupi B) ka të drejtë për një mbështetje të kufizuar, sipas kuotës së përcaktuar me këtë rregullore ($\frac{1}{2}$ e kuotës së plotë). Përfundimisht autorit kryesor, financimi i $\frac{1}{2}$ të kuotës së plotë do të bëhet vetëm për një shoqërues (bashkautor) që lidhet me punimin. Bashkautorët tjerë nuk mund të përfitojnë.

Neni 7

Projektet shkencore e hulumtuese, artistike dhe sportive

1. Projektet shkencore të pranueshme për PNPSH janë kryesisht hulumtimet individuale apo grupe, të realizuara në kampuset e Universitetit të Prishtinës ose në terren nga stafi akademik dhe studentët, të cilët i paraqesin rezultatet e tyre para një auditoriumi më të gjerë (p.sh. seminarët në njësi akademike) me të cilat dëshkohet se ndërlidhen me qëllimin e Research and Development (R&D). Projektet duhet të jenë në funksion të inovacionit dhe të lidhura me prioritetet nacionale dhe më gjerë, por që nuk do të kufizohen vetëm në Kosovë. Detajet specifike do të përgatiten nga menaxhmenti, me rastin e thirrjeve publike, por paraprakisht të merret aprovimi nga Këshilli Drejtues për përmbajtjen e thirrjes.
2. Veprimtaria artistike e sportive, për shkak të specifikave, mund të financohet edhe pa thirrje publike (vetëm me parashtrim të kërkesës dhe të arsyetuar mirë), deri në lartësinë e 20% të fondeve buxhetore për projekte në kuadër të PNPSH-së.
3. Rezultatet nga projektet shkencore e hulumtuese duhet të publikohen ose të jenë të pranueshme (eligible) për komunitetin shkencor. Po ashtu veprimtaria artistike e sportive që financohet përmes programit të projekteve duhet të prezantohet dhe të jetë e pranueshme për komunitetin artistik apo sportiv si dhe Universitetin e Prishtinës.

Kapitulli III

NDARJA E FONDEVE DHE SKEMA E FINANCIMIT TË PNPSH-së

Neni 8

Ndarja e fondeve

1. PNPSH-ja financohet nga buxheti i Universitetit të Prishtinës. Me rastin e financimit të punës shkencore, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, është e detyrueshme që të respektohen me rigorozitet procedurat e përcaktuara me këtë rregullore me paraqitjen e raportit narrativ dhe dëshmisë së publikimit dhe/apo faturave për shpenzimet e bëra, të cilat janë prova të domosdoshme me qëllim të përfitimit nga programi PNPSH.
2. Financimi i publikimit të punimeve shkencore (grupi 1, grupi 2 dhe grupi 3) është në vlerë fikse dhe rimbursohet me rastin e paraqitjes së kërkesës, duke u siguruar që autorësia e punimit lidhet me adresën e Universitetit të Prishtinës. Mbështetja financiare e siguruar nga universiteti apo njësitë akademike mund të përdoren më shumë se një herë në vit, pavarësisht nga burimi financiar, nëse publikimi është realizuar në revista shkencore të mbuluara nga *Clarivate Analytics – Web of Science*. Punimeve nga fushat e shkencave mjekësore, fusha e bujqësisë dhe ushqimit nuk mund t'u ofrohet mbështetje për autorët e njëjtë, të cilët kalojnë më tepër se 3 punime në vit. Përveç kësaj, shumica e mbështetjes që do të jepet nga PNPSH-ja për publikimet shkencore të grupeve 2

dhe 3 nuk mund të tejkalojë dyfishin e shumës së përshkruar për grupin 1 (SCIE; SSCI; AHCI). Shuma e cila ndahet për këto aktivitete nuk kalon 55 % të buxhetit total të ndarë për PNPSH (Tabela 1).

3. Financimi i personelit akademik, me rastin e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, do të kompensohet sipas skemës së ofruar për grupin A dhe grupin B. Shuma financiare që ndahet për këto aktivitete nuk kalon 20 % të buxhetit total të ndarë për PNPSH (Tabela 2).

3.1. Përveç personelit akademik, studentëve të doktoratës të Universitetit të Prishtinës do t'u kompensohen shpenzimet e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, artistike e sportive, një herë për kohën sa zgjat cikli i studimeve të doktoratës.

3.2. Me rastin e ndarjes së mjeteve nga PNPSH-ja, duhet të sigurohet (renditet) për ndarjen e shpenzimeve brenda shumës apo kuotës që parashihet me rregullore, me sa vijon:

(a) Tarifat e regjistrimit për ngjarjet shkencore (conference fee);

(b) Akomodimi si dhe

(c) Shpenzimet e udhëtimit.

3.3. Shuma maksimale e mbështetjes financiare për një person për një ngjarje nuk mund të tejkalojë shumën e përcaktuar nga Këshilli Drejtues i UP-së dhe provat e pagesës së shpenzimeve të përmendura më sipër, duke përfshirë biletat dhe faturat e biletave, faturat e akomodimit, regjistrimin e ngjarjes shkencore, të cilat duhet të paraqiten ose dokumentohen.

3.4. Personeli akademik mund të marrë fonde nga PNPSH-ja vetëm një herë në vit, përkatësisht një herë për kohën sa zgjat cikli i studimeve të doktoratës në nivel të UP-së për pjesëmarrje në aktivitete shkencore. Nëse njësitë akademike kanë programet e tyre të PNPSH-së, të financuara nga buxhetet e tyre ose ndonjë donator, shuma e mbështetjes që do të jepet nga këto programe nuk mund të tejkalojë dyfishin e shumave të përshkruara sipas kësaj rregulloreje për grupin A. Prezantimi i një punimi ndërkombëtar është një domosdoshmëri minimale për mbështetje nga njësitë akademike për pjesëmarrje në ngjarje shkencore.

3.5. Mbështetja e siguar nga njësitë akademike mund të përdoret vetëm një herë në vit, pavarësisht nga burimi financiar sipas paragr.3.4 të këtij neni. Mbështetja nuk mund të sigurohet për herë të dytë gjatë të njëjtit vit, madje edhe për ngjarje të ndryshme.

4. Financimi i projekteve shkencore bëhet mbi bazën e thirrjeve që hap Universiteti i Prishtinës dy herë në vit. Procedurat e financimit do të zhvillohen në një ambient konkurrent dhe menaxhmenti i UP-së është i obliguar që, pavarësisht nga prioriteti i UP-së, të hartojë kriteret, mbi të cilat financohen projektet nga shkencat natyrore dhe të aplikuar, shëndetësore, shoqërore, artistike, sportive etj. Buxheti i ndarë për këtë kategori është deri në 25% të fondeve të ndara për PNPSH, megjithatë, me arsyetim të bazuar dhe me vendim të KD-së, shuma e financimit për një projekt mund të rritet (Tabela 3).

5. Nëse fondet e ndara sipas kategorive të lartshënuara (p.sh. 55%, 25% dhe 20%) nuk shpenzohen sipas destinacionit fillestar, me propozimin e menaxhmentit apo Këshillit Drejtues, me vendim ato mund të ridestinohen brenda kategorive në gjysmën e dytë të vitit përkatës.

6. Këshilli Drejtues, duke marrë parasysh ndryshimet në fushat shkencore dhe efektet e mbështetjes për botime të vlefshme, konferenca, simpoziume, ngjarje artistike, etj., me ose pa propozimin e menaxhmentit të UP-së, mund të sjellë kufizime vjetore të mbështetjes në shkencat natyrore dhe të aplikuara, shëndetësore, shoqërore dhe artistike.

Neni 9

Skema e financimit dhe stimujt financiarë

1. Puna kërkimore shkencore do të financohet për aq sa ka fonde në PNPSH dhe sipas parimit të të parit “i pari për nga koha është i pari edhe për nga e drejta” që paraqet aplikacionin për financim. UP-ja do ta financojë punën kërkimore shkencore deri sa të mos jetë arritur kufiri i sipërm buxhetor (100%) i ndarë për PNPSH-në.

2. Përjashtimisht aktiviteteteve të parapara në nenet 6 dhe 7 të rregullores, buxheti i paraparë për financimin e punimeve shkencore, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, alokohet në proporcion të barabartë për secilën njësi akademike ($1/14 = 7.14\%$). Në rast të mosshfrytëzimit të mjeteve të planifikuara, ato rishikohen në gjysmën e dytë të vitit përkatës dhe të njëjtat mjete ridestinohen, varësisht suksesit të arritur në publikime, duke iu dhënë prioritet punimeve në grupin 1.

3. Skema e financimit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, paraqitet sipas tabelave 1-3, me sa vijon:

Tabela 1. Publikimet shkencore në kuadër të PNPSH-së

Fusha	Gr. 1 (neni 5.1.1)	Shuma	Punime për vit*
Shkenca të Natyrës/Teknike	SCIE, SSCI, AHCI	€ 1,000.00	më shumë se 1
Shkenca Shoqërore/Arteve/Sportit, etj.			
Shk. Mjekësore/Ushqimit/Bujqësisë, etj.	SCIE, SSCI, AHCI	€ 900.00	deri në 3
Fusha	Gr. 2 (neni 5.1.2)	Shuma	Punime për vit
Shkenca të Natyrës/Teknike	Scopus (Q1)	€ 600.00	më shumë se 1
Shkenca Shoqërore/Arteve/Sportit, etj.	Scopus (Q2)	€ 500.00	
Shk. Mjekësore/Ushqimit/Bujqësisë, etj.	Scopus (Q1)	€ 500.00	deri në 3
	Scopus (Q2)	€ 400.00	
Shkenca të Natyrës/Teknike	Scopus (Q3)	€ 400.00	më shumë se 1
Shkenca Shoqërore/Arteve/Sportit, etj.	Scopus (Q4)	€ 300.00	
Shk. Mjekësore/Ushqimit/Bujqësisë, etj.	Scopus (Q3)	€ 300.00	deri në 3
	Scopus (Q4)	€ 200.00	
Fusha	Gr. 3 (neni 5.1.3)	Shuma	Punime për vit
Të ndryshme	<i>Shtëpitë botuese</i>	€ 600.00 (libër) € 200.00 (kapituj)	më shumë se 1

*Nënkupton punime nga një autor apo grup autorësh të fushave përkatëse.

Tabela 2. Pjesëmarrja në aktivitete shkencore/artistike në kuadër të PNPSH-së

Fusha	Grupi A	Shuma	Aktivitete**
Gjithëpërfshirëse, personeli akademik dhe studentët e doktoratës.	Pjesëmarrësit si prezantues i punimit, folës, panelist, kryesues seksioni, etj.	€ 600.00	Konferenca, simpoziume, ekspozita, etj.
	Pjesëmarrësit si shoqërues pa prezantim, etj.	€ 300.00	

**Menaxhmenti do të orientojë shpenzimin e këtyre fondeve sipas rëndësisë/seriozitetit të konferencës, siç definohet në nenin 6 të rregullores. Për grupin B mbështet vetëm një nga bashkautorët me vlerën prej 1/2 të kuotës së plotë.

Tabela 3. Projektet shkencore/hulumtuese në kuadër të PNPSH-së

Fusha	Thirrja e UP-së	Shuma	Projekte për vit***
Të gjitha fushat, pos atyre artistike e sportive.	Janar dhe Qershor	€0.0 – € 8,000	1 projekt për njësi akademike
Projektet Artistike/Sportive		€ 0.0 – € 25,000	brenda buxhetit

***Menaxhmenti do të orientojë shpenzimin e këtyre fondeve sipas prioritetit të UP-së, neni 7 i rregullores. Jo domosdoshmërisht, por projektet artistike mund të financohen edhe pa thirrje publike. Nëse buxheti i kërkuar është mbi limitin e përcaktuar, KD-ja mund të nxjerrë vendim shtesë për lejimin e mjeteve.

KAPITULLI IV

PROCEDURAT PËR REALIZIMIN E MBËSHTETJES NGA PNPSH-ja

Neni 10

Procedurat dhe parashtrimi i kërkesës për financimin e publikimeve shkencore dhe vlerësimi

1. Me qëllim të realizimit të mbështetjes financiare të aktiviteteve hulumtuese dhe shkencore të përcaktuara me këtë rregullore, secili duhet të respektojë me përpikëri procedurat e aplikimit me sa vijon:

1.1. Për aplikimet e personelit akademik për PNPSH në një vit të caktuar, të paktën një botim i vitit të njëjtë ose i një viti më parë do të jenë të nevojshëm për kualifikim. Publikime të tilla duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.

1.2. Në një vit, personeli akademik që ka realizuar botime dy herë ose më shumë, siç përcaktohet në grupin 1, ka të drejtë për mbështetje financiare pa një vendim të KD-së të universitetit, ndërsa për punimet të cilat kategorizohen në grupin 2 dhe grupin 3 mund të kenë të drejtë për mbështetje financiare vetëm një herë në vit.

1.3. Në kërkesat për mbështetje duhet të paraqitet formulari i aplikimit për mbështetje nga PNPSH-ja (Formulari 1), së bashku me dokumentet e mëposhtme:

1.3.1. Publikimet që do të vlerësohen për PNPSH (artikulli i plotë, <https://doi.org/>; emri i revistës dhe shtëpisë botuese, indeksimi në platformën përkatëse, faktori i impaktit – IF, data e pranimit të punimit apo publikimit online);

1.3.2. Detaje mbi prezantimin e punimit në formë të seminarit në katedrën/njësine Akademike, nga e cila vjen autori/bashkautori i punimit;

1.3.3. Një letër që shpjegon përfitimin shkencor nga publikimi i punimit shkencor për Universitetin e Prishtinës duhet t'i paraqitet rektoratit nga nivelet e larta të njësive akademike, siç janë dekanët e fakulteteve ose udhëheqësit e departamenteve, përkatësisht katedrave;

1.3.4. Detajet në lidhje me ngjarjen shkencore që do të ndiqet, si data, qëllimi, arritjet dhe programi (nëse aplikohet);

1.3.5. Dokumentet që tregojnë pranimin e punimit/posterit për prezantim në një kongres, konferencë, simpozium apo ngjarje artistike e sportive dhe praninë e tij në

programin e ngjarjes, si dhe një letër personale të ftesës ose pranimin për prezantimin (nëse aplikohet);

1.3.6. Dokumentacioni i shkruar i ftesës në punëtori ose kurs, si folës ose instruktor, te kandidati (nëse aplikohet).

1.4. Kërkesat për PNPSH duhet të parashtrohen brenda vitit, në të cilin është bërë publikimi i punimit ose të publikimit të një viti më parë. Kërkesa duhet të bëhet në ZKPS, e cila dokumentacionin e bart në “Komisionin e Vlerësimit të Nxitjeve të Publikimeve Shkencore”.

1.5. Dosjet e aplikimit për PNPSH do të vlerësohen nga “Komisioni i Vlerësimit të Nxitjeve të Publikimeve Shkencore”, i formuar nga menaxhmenti i universitetit dhe do t'i paraqiten KD-së si raport i komisionit, të paktën një herë në muaj. Vendimi për shpërndarjen e fondeve nga PNSHP-ja do të merret nga KD i universitetit pas vlerësimit të raportit të komisionit.

1.6. Aplikimi bëhet me shkrim nga autori kryesor dhe autori korrespondent. Pagesa e financimit bëhet për punim, ndërsa rimbursimi i mjeteve bëhet në llogarinë bankare, e cila shënohet në formularët me rastin e kërkesës sipas të dhënave bankare të verifikuara të aplikantit.

1.7. Në rastet kur konstatohet se dokumentacioni nuk është i kompletuar, atëherë komisioni kërkon nga parashtruesi i kërkesës plotësimin e dokumentacionit, andaj shqyrtimi i kërkesës pezullohet deri në plotësimin e dokumentacionit. Nëse kandidati nuk e plotëson dokumentacionin brenda afatit të dhënë nga komisioni, e që nuk mund të jetë më i shkurtër se 5 ditë pune, konsiderohet se kërkesa është tërhequr.

Neni 11

Procedurat që ndiqen gjatë aplikimit për konferenca dhe simpoziume shkencore e artistike (KSSHA) dhe vlerësimi

1. Për aplikimet e personelit akademik për ngjarje shkencore e artistike në një vit të caktuar të drejtë aplikimi ka i gjithë personeli akademik një herë në vit, sipas kushteve të përcaktuara me këtë rregullorë. Kërkesa duhet të bëhet në ZKPS, e cila dokumentacionin e bart në Komisionin e Vlerësimit të Nxitjeve të Publikimeve Shkencore.

2. Në kërkesat për mbështetje financiare duhet të paraqitet formulari i aplikimit KSSHA (Formulari 2), së bashku me dokumentet e mëposhtme:

2.1. Prezantimi apo abstrakti që do të vlerësohet për PNPSH;

2.2. Detajet në lidhje me ngjarjen shkencore që do të ndiqet, si data, qëllimi, arritjet dhe programi;

2.3. Dokumentet që tregojnë pranimin e punimit/posterit, abstraktit për prezantim në një kongres, konferencë, simpozium apo ngjarje artistike e sportive dhe praninë e tij në programin e ngjarjes, si dhe një letër personale të ftesës ose pranimin për prezantimin;

2.4. Dokumentacioni i shkruar i ftesës së aktivitetit apo ngjarjes për kandidatin si folës ose instruktor;

2.5. Një letër, që shpjegon përfitimin shkencor nga pjesëmarrja në ngjarjet shkencore për Universitetin e Prishtinës, duhet t'i paraqitet rektoratit nga administratorë të niveleve të larta të njësisve të tilla si dekanët e fakulteteve ose shefat e departamenteve/katedrave.

3. Kërkesa për KSSHA duhet të bëhet individualisht, të paktën, një muaj para datës së ngjarjes, për të cilën bëhet kërkesa në "Komisionin e Vlerësimit të Nxitjeve të Publikimeve Shkencore".
4. Dosjet e aplikimit për KSSHA do të vlerësohen nga "Komisioni i Vlerësimit të Nxitjeve të Publikimeve Shkencore", i formuar nga menaxhmenti i universitetit dhe do t'i paraqiten KD-së si raport i komisionit, të paktën një herë në muaj. Vendimi për alokimin e fondeve nga PNSHP-ja do të merret nga KD i universitetit, pas vlerësimit të raportit të komisionit.
5. Pagesa e financimit bëhet për person, ndërsa rimbursimi i mjeteve bëhet në llogarinë bankare, e cila shënohet në formularët me rastin e kërkesës.

Neni 12

Procedurat që ndiqen gjatë aplikimit për projekte shkencore, artistike dhe sportive (PSAS) dhe vlerësimi

1. Për aplikimet e personelit akademik për projekte shkencore, artistike dhe sportive në një vit të caktuar, të drejtë aplikimi ka i gjithë personeli akademik dhe studentët e doktoratës që identifikohen me njësinë akademike, institutin apo të ngjashme në kuadër të UP-së. Ngjarje të tilla duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje, si dhe të mos jenë pjesë e financimit dhe trajtimit nga një institucion tjetër. Aplikimi për pjesëmarrje në projekt bëhet në ZKPS.
2. Në kërkesat për mbështetje duhet të paraqitet formulari i aplikimit PSAS (Formulari 3), së bashku me dokumentet e nevojshme që vendosen me rastin e thirrjes nga universiteti.
3. Dosjet e aplikimit për PSAS do të vlerësohen nga "Komisioni i Vlerësimit të Nxitjeve të Publikimeve Shkencore", i formuar nga menaxhmenti i universitetit dhe do t'i paraqiten KD-së si raport i komisionit. Vendimi për alokimin e fondeve nga PNPSH-ja do të merret nga KD i universitetit pas vlerësimit të raportit të komisionit.
4. Pagesa e financimit bëhet për projekt, ndërsa rimbursimi i mjeteve bëhet në llogarinë bankare, e cila shënohet në formularët me rastin e aplikimit. Kompensimi bëhet në dy këste (60%), e para në formë të paradhënies për një pjesë të shpenzimeve, ndërsa kompensimi përfundimtar i pjesës së mbetur bëhet pas përmbylljes së aktivitetit (40%), bazuar në dëshmitë që është realizuar pjesëmarrja dhe një raport për rezultatet e pjesëmarrjes. Rezultatet nga projekti duhet të publikohen ose të jenë të pranueshme për komunitetin shkencor.

Neni 13

Komisioni i Vlerësimit të Nxitjeve të Publikimeve Shkencore

1. Rektori, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, e emëron komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për mbështetje financiare.
2. Përbërja e komisionit duhet të jetë prej pesë (5) anëtarëve nga radhët e personelit akademik të universitetit, të cilët sigurojnë trajtimin e drejtë dhe të paanshëm të të gjitha kërkesave të aplikantëve. Shqyrtimi i kërkesave duhet të zhvillohet në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe

procedurat e vendosura nga UP-ja, në mënyrë që të sigurohet parimi i barazisë, drejtësisë dhe transparencës.

3. Kryesuesi i komisionit është prorektori për kërkime shkencore në Universitetin e Prishtinës.
4. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të mjeteve buxhetore për mbështetjen e aktiviteteve të parapara me këtë rregullore mbajnë përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të kriterëve për mbështetje.
5. Anëtarët e komisionit vlerësues, të paraparë me këtë nen, duhet të deklarojnë paraprakisht mundësinë e ekzistencës së interesit të tyre privat lidhur me vendimmarrjen në raste të caktuara, që mund të jenë shkak për lindjen e konfliktit të interesit sipas ligjit të veçantë për parandalimin e konfliktit të interesit.

Neni 14

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja

1. Komisioni bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për mbështetjen financiare të aktiviteteve shkencore brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më të gjatë se 60 ditë pune nga momenti i dorëzimit të kërkesës.
2. Komisioni mund të nxjerrë rekomandimin nëse janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.
3. Komisioni mban procesverbal gjatë mbledhjeve, i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.
4. Puna e komisionit ndihmohet nga ZKPS-ja.
5. Komisioni, përmes prorektorit për shkencë, i rekomandon Këshillit Drejtues marrjen e vendimit për listën e përfituesve, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
6. Brenda pesë ditëve të punës, pas miratimit nga ana e Këshillit Drejtues, vendimi i përfituesve publikohet në ueb faqen zyrtare të universitetit.
7. Këshilli Drejtues mund të bëjë ndryshime dhe plotësime, sipas vlerësimit të tij, apo të kërkojë që komisioni për vlerësimin e kërkesave ta bëjë rivlerësimin e kërkesave.
8. Këshilli Drejtues merr vendim, duke marrë në konsideratë rekomandimin e komisionit vlerësues të kërkesave, në afat prej 15 ditë pune.

Neni 15

Raportet e projekteve shkencore

1. Periudha kohore e raportimit, e paraparë me këtë rregullore, duhet të përfundojë brenda 30 ditëve kalendarike pas përfundimit të aktivitetit.
2. Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni protokollohet dhe një kopje e tij dorëzohet në arkivin e universitetit.
3. Këshilli Drejtues ka të drejtë në monitorimin e përfituesve në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit për mjetet e ndara dhe ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga universiteti.

Neni 16

E drejta e ankesës

Secili subjekt i pakënaqur me vendimin për njohjen apo refuzimin e të drejtës, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, ka të drejtë t'i paraqesë ankesë Këshillit Drejtues në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

KAPITULLI V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Dispozitat kalimtare

Ndarja e mjeteve financiare e bërë para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje vazhdon të zbatohet sipas rregullativës ekzistuese.

Neni 18

Shfuqizimi


1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen:

- 1.1 Rregullorja mbi kriteret për ndarjen e bursave, shpërblimeve dhe formave tjera të mbështetjes financiare të Universitetit të Prishtinës nr. 3/542 të datës 19.12.2013;
- 1.2 Vendimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, nr. 2/297 i datës 14.11.2014, për plotësim dhe ndryshim të rregullores nr. 3/542, të datës 19.12.2013, mbi kriteret për ndarjen e bursave, shpërblimeve dhe formave të tjera të mbështetjes financiare të Universitetit të Prishtinës;
- 1.3 Rregullorja për mbështetje të mobilitetit të stafit akademik nr. 1/140, e datës 2.6.2015 dhe të gjitha dispozitat e rregulloreve që përmbajnë dispozita lidhur me objektin e kësaj rregulloreje.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Drejtues.



KËRKESË PËR FINANCIM TË PUBLIKIMIT SHKENCOR
(Formulari 1)

1. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____ THIRRJA SHKENCORE: _____
NJËSIA AKADEMIKE: _____ THIRRJA AKADEMIKE: _____
AUTOR KRYESOR: _____
AUTOR KORRESPONDENT: _____
BASHKAUTORËT: _____

2. DETAJET E PUBLIKIMIT:

PËRKATËSIA E AUTORIT
(AFFILIATION): _____
TITULLI I PUNIMIT: _____
DOI: _____
EMRI I REVISTËS: _____
SHTËPIA BOTUESE _____
INDEKSIMI NË
PLATFORMËN: _____
IMPAKT FAKTORI (IF): _____ SCOPUS (Q1-Q4): _____
DATA E PRANIMIT: _____ DATA E PUBLIKIMIT: _____
LINKU I PUBLIKIMIT: _____

3. PREZANTIMI NE NJËSINË AKADEMIKE (BASHKËNGJIT DËSHMINË):

ËSHTË PREZANTUAR SI AKTIVITET NË:

	PO	JO
KONFERENCE	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
NJËSINË AKADEMIKE	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

SQARO MËNYRËN E PREZANTIMIT:

4. RAPORT NGA DEKANI APO UDHËHEQËSIT E DEPARTAMENTEVE/KATEDRAVE NE NJËSINË AKADEMIKE:

Shënimi: kjo pjesë duhet të mbështetet me një letër që shpjegon përfitimin shkencor nga publikimi i punimit shkencor për Universitetin e Prishtinës dhe duhet t'i paraqitet rektoratit nga nivelet e larta të njësisve akademike, siç janë dekanët e fakulteteve ose udhëheqësit e departamenteve, përkatësisht katedrave.

5. INFORMATA NËSE PUNIMI ËSHTË PREZANTUAR NE KONFERENCE/SIMPOZIUME (NËSE APLIKOHET):

Shëno detajet e organizmit të konferencës apo simpoziumit:

LINKU I KONFERENCËS: _____

VENDI I KONFERENCËS: _____ DATA: _____

6. TË DHËNAT BANKARE TË PËRFITUESIT – AUTORIT TË PARË OSE AUTORIT KORRESPONDENT:

EMRI DHE MBIEMRI I APLIKANTIT: _____

EMRI BANKËS: _____

NUMRI I LLOGARISË BANKARE: _____

SWIFT KODI: _____

VENDI: _____

SHUMA E KËRKUAR: EURO _____ SHËNO ME FJALË: _____

7. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____

NËNSHKRIMI: _____

DATA DHE VENDI: _____

PLOTËSOHET NGA ZYRA PËR KËRKIME DHE PROJEKTE TË SPONSORIZUARA NË UP

8. SHQYRTIMI I KËRKESËS:

DATA E PRANIMIT NË ZKPS: _____

ZYRTARI I PRANIMIT: _____

KONTROLLI I DOKUMENTACIONIT:

I KOMPLETUAR

PAKOMPLETUAR

NËNSHKRIMI: _____

DATA : _____

**FORMULAR I APLIKIMIT PËR FINANCIM TË PJESËMARRJES NË KONFERENCA DHE
SIMPOZIUME SHKENCORE, ARTISTIKE DHE SPORTIVE
(Formulari 2)**

1. PARASHTRUESI I KËRKESES:

EMRI DHE MBIEMRI: _____ THIRRJA SHKENCORE: _____

NJËSIA AKADEMIKE: _____ THIRRJA AKADEMIKE: _____

AUTORI KRYESOR: _____

BASHKËPJESËMARRËSI: _____

**2. DETAJET E KONFERENCES, SIMPOZIUMIT OSE AKTIVITETIT SHKENCOR,
ARTISTIK DHE SPORTIV:**

EMËRTIMI I NGJARJES: _____

VENDI DHE DATA: _____

ORGANIZATORI: _____

FTESA DHE PROGRAMI: _____

TITULLI I PUNIMIT DHE
ABSTRAKTI: _____

KONFIRMIMI I
PRANIMIT TË PUNIMIT:
AUTORËT E PUNIMIT
(AFFILIATION): _____

FOLES ME
KUMTESË/POSTER: _____ NGJARJE ARTISTIKE/
SPORTIVE: _____

KRYESUES/PANELIST: _____

LINKU I PUBLIKIMIT TË
NGJARJES: _____

3. RAPORT NGA DEKANI APO UDHËHEQËSIT E DEPARTAMENTEVE/ KATEDRAVE NË NJËSINË AKADEMIKE:

Shënimi: kjo pjesë duhet të mbështetet me një letër që shpjegon përfitimin shkencor nga pjesëmarrja në aktivitetin shkencor, artistik dhe sportiv për Universitetin e Prishtinës dhe duhet t'i paraqitet rektoratit nga nivelet e larta të njësive akademike, siç janë dekanët e fakulteteve ose udhëheqësit e departamenteve, përkatësisht katedrave.

4. TË DHËNAT BANKARE TË PËRFITUESIT – AUTORIT KRYESOR/BASHKËPJESËMARRËSIT:

EMRI DHE MBIEMRI I APLIKANTIT: _____

EMRI BANKËS: _____

NUMRI I LLOGARISË BANKARE: _____

SWIFT KODI: _____

VENDI: _____

SHUMA E KËRKUAR: EURO _____ SHËNO ME FJALË: _____

5. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____

NËNSHKRIMI: _____

DATA DHE VENDI: _____

PLOTËSOHET NGA ZYRA PËR KËRKIME DHE PROJEKTE TË SPONSORIZUARA NË UP

6. SHQYRTIMI I KËRKESËS:

DATA E PRANIMIT NË ZKPS: _____

ZYRTARI I PRANIMIT: _____

KONTROLLI I

DOKUMENTACIONIT:

I KOMPLETUAR

PAKOMPLETUAR

<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>

NËNSHKRIMI: _____

DATA : _____

**FORMULAR I APLIKIMIT PËR FINANCIM TË PROJEKTEVE SHKENCORE,
ARTISTIKE DHE SPORTIVE
(Formulari 3)**

1. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____

NJËSIA AKADEMIKE: _____

DEPARTAMENTI/KATEDRA/DEGA/INSTITUTI: _____

EMRI I PROJEKTIT: _____

BARTËSI KRYESOR I PROJEKTIT: _____

BASHKËPUNETORET: _____

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT SHKENCOR/ARTISTIK/SPORTIV (deri në 20 faqe):

Duhet të përdoret madhësia e shkronjave 12 (Times new roman) me 1.5 hapësira të rreshtave.

2.1 Përmbledhje (1-2 faqe): përshkruani rëndësinë dhe arsyetimin e projektit, renditni objektivat e përgjithshme dhe qëllimet specifike, metodat e realizuara, rezultatet e pritura dhe ndikimi i tyre në sferën shkencore, artistike dhe sportive në vend dhe më gjerë.

2.2. Përshkrimi i detajuar i projektit (deri në 18 faqe): përshkruani projektin në kontekstin e gjendjes aktuale në fushën tuaj dhe paraqiteni referencat kryesore. Paraqiteni projektpropozimin në detaje duke u bazuar në objektivat kryesore, metodologjinë, rezultatet e pritshme, rëndësinë dhe ndikimin e projektit për disiplinën dhe shkencën në tersi (kërkime, edukim dhe mësimdhënie), planin kohor dhe financiar. Përshkruani rolin e secilit anëtar të ekipit dhe mënyrën e botimit të rezultateve të hulumtimit (artikuj në revista shkencore, monografi, ngjarje të rëndësishme artistike dhe sportive, konferenca ose simpoziume).

3. CV DHE PUBLIKIMET (bashkëngjiti):

Të dorëzohen CV dhe publikimet e bartësit kryesor të projektit dhe bashkëpunësorëve.

4. REKOMANDIMI PËR APLIKIM:

Kjo pjesë duhet të mbështetet me një letër që shpjegon përfitimin shkencor të projektit për Universitetin e Prishtinës, e cila duhet t'i paraqitet rektoratit nga nivelet e larta të njësive akademike, siç janë dekanët e fakulteteve ose udhëheqësit e instituteve, departamenteve ose katedrave.

5. TË DHËNAT BANKARE TË PËRFITUESIT:

EMRI DHE MBIEMRI I APLIKANTIT: _____

EMRI BANKËS: _____

NUMRI I LLOGARISË BANKARE: _____

SWIFT KODI: _____

VENDI: _____

SHUMA E KËRKUAR: EURO SHËNO ME FJALË: _____

6. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____

NËNSHKRIMI: _____

DATA DHE VENDI: _____

PLOTËSOHET NGA ZYRA PËR KËRKIME DHE PROJEKTE TË SPONSORIZUARA NË UP

7. SHQYRTIMI I KËRKESËS:

DATA E PRANIMIT NË ZKPS: _____

ZYRTARI I PRANIMIT: _____

KONTROLLI I DOKUMENTACIONIT:

I KOMPLETUAR

PAKOMPLETUAR

NËNSHKRIMI: _____

DATA : _____